

STRATEGJITË NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË



STRATEGJITË NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

STRATEGJITË NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË



admovere

botues:

ADMOVEVERE

(drejtësi tranzicionale | edukim | paqëndërtim)

<http://admovere.org/>

autorë:

Aulonë Memeti

Nuhi Sadiku

hulumtues:

Nuhi Sadiku

Fitore Metbala

Samir Shahini

Recensent:

Xhavit Rexhaj

Korrektura gjuhësore:

LBG Communications

dizajni i kopertinës dhe faqosja:

ThinkB

shtypi:

VM3

shtator 2021

Prishtinë

tirazhi:

200 kopje

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

KFOS (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

ADMOVEVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), të mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së ADMOVEVERE dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të KITU-së, e as të recensentëve.

ADMOVEVERE (drejtësi tranzicionale | edukim | paqëndërtim) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e të bashkëjetesës dhe luftimin e paragjyqimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë te drejtësia tranzicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes. Për më shumë: <http://admovere.org/>

PËRMBAJTJA

- 06** Shkurtesat
- 07** Falenderimet
- 08** Fjala e recensentit
- 10** Hyrja
- 11** Përmbledhja e dokumenteve kryesore
- 23** Indikatorët
- 42** Vlerësimi i zbatimit të indikatorëve përmes hulumtimit cilësor
- 46** Rekomandimet
- 48** Referencat

SHKURTESAT

- AAP** – Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKA – Agjencia e Kosovës për Akreditim
BPV – Bruto Produkti Vendor
DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit
ENQA – European Association for Quality Assurance (in Higher Education)
EQAR – The European Quality Assurance Register (for Higher Education)
FIEK – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë
KEK – Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KFOS – Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KITU – Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NVM – Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
PRE – Programi për Reforma Ekonomike
PSAK – Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
PSUP – Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës
SMIAL – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
SKZH – Strategjia Kombëtare për Zhvillim
UP – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

FALENDERIME

Falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan për këtë publikim përmes intervistave, ofrimit të të dhënave publike, ndarjes së informatave dhe bashkëpunimit. Së pari, falënderojmë Rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", z. Naser Sahiti për pritjen në takim dhe për sugjerimet, zëvendësministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, z. Dukagjin Pupovci, si dhe kabinetin e Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për bashkëpunimin e tyre. Po ashtu, falënderojmë për zemërsisht dekanët e tre fakulteteve të UP-së: z. Isak Shabani, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, z. Blerim Saqipi, Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe z. Dashmir Bërxulli, Dekan i Fakultetit të Filozofisë, për zhvillimin e intervistave dhe ofrimin e të dhënave. Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në tryezën e organizuar për të diskutuar versionin punues të këtij raporti. Në veçanti, falënderojmë z. Xhavit Rexhaj, profesor dhe ekspert i arsimit, për kritikën dhe sugjerimet e çmuara përgjatë të gjithë hulumtimit.

Në fund, falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) për mbështetjen financiare për hulumtimin dhe publikimin e këtij raporti, LBG Communications për korrekturën gjuhësore dhe përkthimin e raportit, ThinkB për dizajnin dhe faqosjen, si dhe VM3 për shtypin.

FJALA E RECENSENTIT

Ky studim i organizatës ADMOVERE fokusohet në një temë me rëndësi kyçe për funksionimin e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe të autoriteteve arsimore përgjegjëse për sektorin e arsimit të lartë në Kosovë. Planifikimi strategjik në përgjithësi, por edhe procesi i hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve strategjike në të gjitha nivelet e arsimit të lartë është tregues i besueshëm për performancën e institucioneve tona përgjegjëse për arsimin e lartë. Raportet e trajtuara të monitorimit të planeve të ndryshme strategjike dhe rezultatet e hulumtimit të prezantuara në raportin në fjalë tregojnë për shkallë shumë të ulët, madje tejet brengosëse, të implementimit të planeve strategjike në të gjitha nivelet. Kjo deri diku mund të shpjegohet me ndikimin negativ që ka pasur pandemia COVID-19 në dy vitet e fundit mbi funksionimin e gjithëmbarshtëm të institucioneve arsimore, por edhe të shoqërisë kosovare në përgjithësi.

Koha kur është zhvilluar ky hulumtim përkon me një vit të rëndësishëm për planifikimin strategjik në sektorin e arsimit të lartë në nivel shtetëror. Në të vërtetë, në vitin 2021 përfundon afati i dy planeve kombëtare strategjike, përkatësisht i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 dhe i Planit Strategjik të Arsimit në Republikën e Kosovës 2017-2021. Tashmë, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, edhe MASHTI, e kanë filluar procesin e hartimit të planeve përkatëse strategjike për periudhën e ardhshme zhvillimore. Njëkohësisht, gjetjet e këtij Raporti mund t’u hyjnë në punë edhe ekipeve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për rishikimin e Planit Strategjik 2020-2022 dhe për organizimin e procesit të hartimit të Planit Strategjik për periudhën e ardhshme zhvillimore. Mbase do të ishte e udhës që Universiteti i Prishtinës të fillojë me planifikimin e hershëm të Planit Strategjik 2022-2027 për shkak të pasojave të pandemisë COVID-19 në shkallën e ulët të zbatimit të Planit të tanishëm Strategjik (2020-2022). Gjetjet dhe rekomandimet e raportit mund të shërbejnë për të siguruar koherencë dhe qasje më sistematike në të gjitha nivelet e planifikimit të zhvillimit të arsimit të lartë – gjë që ka munguar shumë në periudhën që po e lëmë pas. Raporti mund të kishte realizuar pasqyrë më të plotë për gjendjen e planifikimit në institucionet dhe autoritetet arsimore sikur të kishte pasur mundësi të trajtonte edhe planet zhvillimore e strategjike të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Kosovë.

Temat e përzgjedhura për shqyrtim nga ana e ekipit hulumtues janë po ashtu më se të qëlluara:

- transparenca dhe llogaridhënia,
- puna shkencore,
- gjithëpërfshirja,
- ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës, dhe
- akreditimi.

Secila prej këtyre temave prek thelbin e misionit dhe të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Njëkohësisht, këto tema e sigurojnë edhe koherencën e brendshme të hulumtimit dhe të raportit përfundimtar. Pos këtyre temave, raporti prek edhe temën e ndërkombëtarizimit në institucionet e arsimit të lartë, si një trend tjetër i rëndësishëm në arsimin e lartë në kuadër të proceseve të globalizimit dhe të zhvillimeve të hovshme teknologjike në vend dhe në botë. Kësisoj, ekipi hulumtues ka arritur ta ruajë gjithëpërfshirjen (duke e trajtuar planifikimin strategjik në nivel vendor, sektorial dhe institucional) dhe relevancën (duke trajtuar temat kryesore në arsimin e lartë).

Në fund, duhet konstatuar se raporti identifikon çështjet kryesore dhe mangësitë që duhen trajtuar për përmirësimin e gjendjes në planifikim strategjik, por edhe në menaxhimin e proceseve zhvillimore në arsimin e lartë. Për trajtimin e mangësive të konstatuara, raporti jep rekomandimet relevante dhe specifike për secilin nivel dhe institucion, përkatësisht.

HYRJA

Duke qenë se performanca e institucioneve të arsimit të lartë në veçanti dhe gjendja e arsimit në Kosovë në përgjithësi, jo rrallëherë është konsideruar e pakënaqshme nga masa e gjerë, shoqëria civile, perceptimet e studentëve dhe vetë institucionet relevante, është e rëndësishme që të analizohen strategjitë e arsimit të lartë për të parë se sa ka koordinim mes tyre, nivelin e redundancës dhe të përsëritjes së objektivave. Meqenëse Plani i ri Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) është aktualisht duke u përpiluar, shtrohet pyetja: a ka ardhur koha për një planifikim të mirëfilltë, dhe nëse po, çka nënkupton kjo?

Projekti ka për qëllim që të analizojë dhe krahasojë trendet e vlerësimit të problematikave në arsimin e lartë në aspektin institucional. Më konkretisht, hulumtimi përqëndrohet në pesë indikatorë:

- transparenca dhe llogaridhënia,
- puna shkencore,
- gjithëpërfshirja,
- ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës, dhe
- akreditimi.

Hulumtimi krahason dhe shqyrton objektivat e përcaktuara dhe nivelin e përmbushjes së tyre në mes të të gjitha strategjive (dhe planeve të veprimit) të arsimit të lartë në Kosovë, të nxjerra nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), dhe në mes të strategjive universitare (dhe raporteve vjetore) të Universitetit të Prishtinës (UP).

Për nevojat e këtij hulumtimi, me theks të veçantë janë shqyrtuar Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe udhërrëfyesi për zbatimin e saj, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 dhe Plani i Veprimit, Planet Strategjike të UP-së 2017-2019 dhe 2020-2022. Për të vlerësuar zbatimin e strategjive, me fokus tek indikatorët e lartpërmendur, janë shqyrtuar më hollësisht rastet e tre fakulteteve të UP-së, përkatësisht Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Filozofisë. Për këtë, janë zhvilluar intervista të thelluara me menaxhmentet përkatëse. Për më shumë, në kuadër të këtij projekti është paraparë një tryezë pune me personat përgjegjës dhe me përfaqësuesit e institucioneve relevante të arsimit të lartë, me njohësit dhe ekspertët e arsimit, me organizatat që në fokus kanë arsimin, e me radhë. Rekomandimet e kësaj tryeze do të inkorporohen në raportin final.

PËRMBLEDHJA E DOKUMENTEVE KRYESORE (2016 – 2022)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 - 2021

Kjo strategji paraqitet si një qasje e re zhvillimore dhe adreson faktorët që janë pengesë për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardeve të jetës. Strategjia synon t'i prioritetizojë nevojat e vendit tonë nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të analizës gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Gjithashtu, strategjia synon që t'i parandalojë proceset e dyfishta institucionale dhe të rrisë eficiencën e punës. Hisedarë të këtij dokumenti janë: institucionet shtetërore, sektori privat, shoqëria civile, partnerët zhvillimorë, dhe për të qenë të efektshëm, nevojitet kontributi i secilit si zbatues ose si mbikëqyrës.

Plani Kombëtar Zhvillimor 2016-2021 tregon koherencë të fushave të intervenimit dhe karakterizohet nga një qasje e bazuar në program e në projekte (e jo në intervenim sistematik strategjik). Planit duket të jetë hartuar nga një grup i përzgjedhur i ekspertëve. Ky Plan e sheh arsimin si një nga prioritetet kryesore zhvillimore, duke e përfshirë në shtyllën e parë tematike për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor. Një numër i konsiderueshëm (7) i masave konkrete i referohen zhvillimit të arsimit dhe të burimeve njerëzore në kuadër të një qasjeje të gjithëmbarshme dhe koherente zhvillimore.

Strategjia dallon nga dokumentet e tjerë për shkak të orientimit të politikave dhe kohës së implementimit. Meqenëse merr pesë (5) vjet për implementim, Strategjia shkon përtej mandatit të një qeverie. SKZH-ja është e harmonizuar me procese të tjera strategjike të vendit, sikurse: procesi i integritimit në BE përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) apo Programit për Reforma Ekonomike (PRE).

Rolin prijës dhe koordinues në përgatitjen e këtij dokumenti e ka pasur Zyra për Planifikim Strategjik (me mandat nga Qeveria e Kosovës), ndërsa mbështetja teknike është dhënë nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë. Përpilimi i këtij dokumenti ka filluar ditën që është marrë vendimi nga Qeveria e Kosovës. Pastaj, kanë pasuar takime konsultative brenda mekanizmave shtetërorë, mirëpo edhe jashtë tyre, sepse dokumenti ka qenë i hapur për diskutim edhe me publikun. Gjithashtu, janë marrë edhe idetë e shoqërisë civile, sektorit privat dhe të palëve të tjera të interesit.

Përzgjedhja e prioriteteve është bërë duke u bazuar në dy parime të përgjithshme. Parimi i parë është nevoja për të siguruar norma vjetore më të larta të rritjes ekonomike (nënkupton rritjen e të ardhurave dhe punësimit). Parimi i dytë është që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe kohezion shoqëror dhe, siç u përmend më lart, gjithëpërfshirje. Gjithëpërfshirja duhet të jetë e padiskutueshme, sepse përveçse që është parakusht për drejtësi shoqërore, nëpërmjet saj mundësohet rritje më e qëndrueshme ekonomike.

Strategjia identifikon edhe natyrën e pengesave, mirëpo edhe natyrën e intervenimeve. Sa i përket pengesave, e përbashkëta e tyre është se ato ndikojnë direkt apo indirekt në kufizimin e sasisë dhe produktivitetit të kapitalit dhe fuqisë punëtore të vendit: dy faktorë të nevojshëm për rritjen ekonomike. Dështimi i tregut, dekurajimi i investitorëve strategjikë, ikja nga inovacioni dhe keqpërdorimi i burimeve të vendit tonë janë vetëm disa nga sfidat që mund të shkaktojnë pengesa të natyrave të ndryshme.

Ndërkaq, natyra e intervenimeve ndaj këtyre pengesave është tërësisht pragmatike dhe e vë theksin te rritja ekonomike, duke u bazuar në sektorin privat dhe parimin e konkurrueshmërisë. Për të arritur konkurrueshmërinë, Strategjia vlerëson se është jetik forcimi i sektorit privat. Kjo bëhet vetëm nëpërmjet rolit aktiv të shtetit. Intervenimet që përcaktohen në thelb nuk janë intervenime finale të detajuara, por karakteri i tyre në parim është udhëzues dhe orientues. Për shkak të fazave të ndryshme në të cilat gjenden sektorë të ndryshëm të vendit tonë, disa i kanë të përcaktuara prioritetet dhe mënyrat e zgjidhjes e disa ende janë në fazat më fillestare, masat e parapara të ndërmerren në këta sektorë variojnë nga njëri tek tjetri. Megjithatë, natyra e këtij dokumenti nuk është statike, por mund të evoluojë nga çasti në çast, varësisht nga rrethanat objektive.

Për nga struktura, SKZH-ja është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese, si dhe zhvillimi i infrastrukturës. Këto shtylla bëjnë që kjo të jetë strategji që premtun Punë, Ligj, Afarizëm dhe Ndërtim (PLAN). Pra, SKZH-ja, siç u tha më lart, është PLAN për punë, për forcimin e sundimit të ligjit, për afarizëm dhe për infrastrukturë.

Në kapitullin vijues do të ndalemi në hollësi dhe do të analizojmë se çka parasheh (nëse parasheh) SKZH-ja, veç e veç për secilin indikator të arsimit të lartë. Ndaj këtu do të paraqesim në një formë të përmbledhur pikat kryesore të intervenimit në rrafshin e arsimit, meqenëse hulumtimi ynë i kushtohet ekskluzivisht arsimit, konkretisht arsimit të lartë. **SKZH-ja fokusohet në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në arsim, nëpërmjet këtyre hapave:**

- Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor dhe fillor,
 - Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar,
 - Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës,
 - Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor,
 - Optimizimi i shpenzimeve në arsim nëpërmjet sistemeve të të dhënave,
 - Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve nga diaspora, dhe
 - Adresimi i punësimit joformal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë.
-

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017 – 2021

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë është dokumenti thelbësor për zhvillimin e arsimit në Kosovë në një interval kohor të caktuar (në rastin tonë, në intervalin kohor 2017-2021). Procesi i hartimit të këtij dokumenti ka filluar në vitin 2015 dhe struktura organizative ishte e ndarë në tri nivele: Grupi Bërthamë, Grupi Plenar dhe nëngrupet tematike.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 është plan i bazuar në qasjen sektoriale dhe gjithëpërfshirëse gjatë procesit të planifikimit. Rrjedhimisht, PSAK-u mëton t'i mbulojë të gjithë nënsektorët kryesorë në sistemin e arsimit në Kosovë (prej edukimit parashkollor deri në arsimin e lartë), duke përfshirë madje edhe elemente të kërkimit shkencor në kuadër të objektivit të arsimit të lartë. Plani përfshin të gjitha segmentet e planifikimit strategjik: misionin, vizionin, caqet kryesore, objektivat strategjike, si dhe masat e aktivitetet për sendërtimin e tyre. Njëkohësisht, PSAK-u është dokument voluminoz që përfshin edhe kornizën e rreziqeve, kornizën e monitorimit dhe vlerësimit të performancës, planin e komunikimit, buxhetin dhe planin e veprimit.

Rikujtojmë që planet e para gjithëpërfshirëse për arsimin e lartë ishin: Strategjia e Arsimit të Lartë 2005-2015, Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 dhe Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016. Prandaj, për të pasur një rrjedhë normale të proceseve, PSAK 2017-2021 do të duhej të ishte në harmoni të plotë me planet e sipërpërmendura, por jo vetëm, pasi është vlerësuar si i domosdoshëm edhe harmonizimi i tij me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të hartuar nga Zyra e Kryeministrit, konkretisht me kapitullin e parë: Kapitali Njerëzor. Gjithashtu, PSAK-u synonte që objektivat e tij strategjike dhe pikat ku duhej intervenuar të ishin në përputhje të plotë me prioritetet e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Qeveria e Kosovës: Programi i Qeverisë 2015) në fushën e arsimit dhe shkencës:

-
- Reformat strukturore në arsim,
 - Rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim,
 - Sigurimi, garantimi dhe rritja e cilësisë së arsimit,
 - Menaxhimi i institucioneve të arsimit (përfshirë decentralizimin e vendimmarrjes në arsim),
 - Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar,
 - Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve, dhe
 - Rritja e financimit të arsimit dhe shkencës.
-

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, siç theksohet po aty, ka nisur të përpilohet vetëm pasi është bërë vlerësimi për Planin Strategjik paraprak të Arsimit në Kosovë dhe pasi është kryer një analizë nga Grupi Bërthamë. Ky Plan është paraparë t'i përmbajë shtatë dimensione kryesore/objektivë strategjikë:

-
1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja,
 2. Menaxhimi i sistemit arsimor,
 3. Sigurimi i cilësisë,
 4. Zhvillimi i mësimdhënësve,
 5. Mësimdhënia dhe të nxënit,
 6. Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve, dhe
 7. Arsimi i lartë.

Duke qenë se fokusi ynë është tek arsimi i lartë, PSAK-u i ka evidentuar sfidat kryesore që pengojnë zhvillimin më të hovshëm të arsimit të lartë. Ato janë si vijon:

-
- Shpërputhja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës,
 - Raporti i disfavourshëm ndërmjet numrit të stafit akademik dhe studentëve,
 - Mosinkurajimi i punës kërkimore-shkencore në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL),
 - Mungesa e të dhënave në IAL,
 - Niveli i ulët i kapaciteteve për hartimin e projekteve,
 - Mungesa e formulës për financimin e IAL bazuar në performancë,
 - Mungesa e praktikës profesionale për studentët, dhe
 - Numri i vogël të diplomuarve.

PSAK-u, nëpërmjet intervenimeve të parapara, synon që të rrisë cilësinë dhe konkurrueshmërinë, të nxisë përsosmërinë në mësimdhënie, të rrisë nivelin e kërkimit shkencor, të krijimtarisë artistike, të inovacionit dhe të fokusohet në ndërkombëtarizim. Disa nga rezultatet që planifikohet të realizohen nga aktivitetet e parapara janë:

-
1. Raporti staf akademik-student në IAL të jetë të paktën 1:40,
 2. Mekanizmat për zhvillim profesional të jenë plotësisht funksionalë,
 3. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë të jenë plotësisht funksionalë,

- 4.** Të avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike,
 - 5.** Deri në vitin 2019, Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL) të jetë plotësisht funksional,
 - 6.** Programet e studimit të jenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë të jenë funksionale në IAL,
 - 7.** Numri i publikimeve shkencore i stafit akademik nëpër revista të indeksuara ndërkombëtare të rritet për çdo vit nga 25%,
 - 8.** Deri në vitin 2018 të rishikohet dhe kompletohet infrastruktura ligjore për arsimin e lartë,
 - 9.** Deri në vitin 2020 të fillojë zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performancës,
 - 10.** Të rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve në IAL, dhe
 - 11.** Të rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimet shkencore;
-

Gjithashtu, PSAK-u liston edhe një sërë aktiviteteve të mundshme për t'i arritur këto rezultate, mirëpo për aktivitetet në fjalë dhe zbatimin e tyre në praktikë do të flasim më gjerësisht në kapitujt vijues.

Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës «Hasan Prishtina» 2017-2019

Universiteti i Prishtinës «Hasan Prishtina» është institucioni më i madh publik i arsimit të lartë në vend. Kësisoj, mbi të bie barra kryesore dhe përgjegjësia shtetërore dhe qytetare në edukimin e mirëfilltë të brezave të rinj të Republikës së Kosovës, duke i bërë këta të fundit qytetarë të dobishëm për vendin. Duhet thënë se, edhe sot kur janë shtuar institucionet e arsimit të lartë, UP-ja mbetet adresa parësore e shumicës së studentëve të Republikës së Kosovës.

Në Misionin e paraqitur në Planin Strategjik të UP-së 2017-2019, thuhet si vijon: Universiteti është institucion publik autonom i arsimit të lartë që zhvillon arsimin akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike, ndërsa qëllimet e tij janë:

1. Të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës,
2. Të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës,
3. Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare,
4. Të synojë të krijojë dhe të mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike,
5. T'i shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase,
6. Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar,
7. T'u përshtatet standardeve evropiane, dhe
8. Të integrohet plotësisht në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndërmarrë hapa adekuatë reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni.

Plani Strategjik i UP-së 2017-2019 adreson çështje që lidhen me ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet e UP-së dhe për të gjitha çështjet jep zgjidhjet që i parasheh. Kësisoj, sa për ta ilustruar se si ky dokument e sheh problemin dhe zgjidhjet që i planifikon, implementimi i këtij dokumenti, parashihet t'i sigurojë UP-së cilësi në mësimdhënie duke:

- qenë transparent në procesin e përzgjedhjes së mësimdhënësve,
- forcuar kriteret në përzgjedhje të stafit më të kualifikuar,

- bërë avancimin e stafit vetëm në baza meritore në respektim të Statutit të institucionit,
- trajnuar stafin me metodat e mësimdhënies në përshtatje të lëndës dhe nevojave të studentëve,
- siguruar komunikimin e vazhdueshëm studentë-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësimnxënies,
- nxitur kërkimin shkencor tek mësimdhënësit dhe studentët, duke ofruar praktikë mësimore krahas teorisë, dhe
- nxitur studentët të jenë pjesë aktive e të nxënit dhe të jenë faktor në ndryshimet e nevojshme të proceseve brenda UP-së.

Gjithashtu, me implementimin e këtij dokumenti do të nxitet avancimi i cilësisë së shërbimeve administrative në UP:

- duke përditësuar sipas nevojës shërbimet digjitale për studentët dhe stafin,
- duke informuar në kohë studentët për ngjarjet, bursat, konferencat, mobilitetet dhe aktivitete të lira për jetën në kampusin universitar,
- duke ofruar trajnime për stafin administrativ dhe akademik në përdorimin e aplikacioneve online në shërbim të studentëve,
- duke ofruar qasje në biblioteka elektronike gjatë gjithë kohës (24 orë në ditë), dhe
- duke ofruar shërbime në lehtësim të procesit të mësimnxënies dhe realizimit të detyrave studentore,

Së këndejmi, do të sigurohet cilësia e programeve për sigurim të akreditimit të vazhdueshëm të tyre duke:

- ndërtuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë,
- analizuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht mbarëvajtjen e programeve,
- ofruar programe të reja apo shuarjen e programeve aktuale varësisht prej nevojave të tregut të punës dhe përgatitjes sa më të mirë të studentëve për tregun e punës,
- mbikëqyrur dhe vlerësuar angazhimin e stafit akademik,
- përshtatur numrin e stafit akademik me numrin e studentëve për mësimnxënie efektive,
- inkurajuar mësimdhënësit të nxisin debat në klasë me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik të studentëve dhe shprehjes së lirë,
- themeluar mekanizma për sigurim të cilësisë në të gjitha departamentet e UP-së, dhe

- përfshirë në proces të sigurimit të cilësisë studentët aktualë dhe të diplomuarit e UP-së, kështu që të mbillet një kulturë e vetëkontrollit të cilësisë për të ofruar një arsimit sa më cilësor për studentët dhe për të siguruar një rritje të vazhdueshme të institucionit krahas me cilësinë.

Ndërsa, ky dokument përmirësimin e infrastrukturës fizike e sheh kështu, duke:

- rritur numrin dhe sipërfaqen e objekteve mësimore në përputhje me numrin e studentëve të rregullt,
- ofruar salla mësimore dhe laboratorë të pajisur me mjetet e punës varësisht prej nevojave të programit,
- ofruar ambiente komode/ambiente për lexim,
- duke pajisur bibliotekat me kompjuterë për qasje në e-bibliotekat dhe pajisje të nevojshme në lehtësim të procesit të të nxënit,
- pajisur klasat/sallat me pajisje, si: kompjuterë, projektorë, internet për të lehtësuar mësimdhënien dhe për të mundësuar përdorimin e një mësimdhënieje që nxit përdorimin e teknologjisë, dhe
- siguruar në mënyrë të menjëhershme kushtet për persona me nevoja të veçanta për qasje sa më të lehtë në kampusin e UP-së dhe marrjen e shërbimeve nga UP-ja.

UP-ja, me anë të këtij dokumenti ka caktuar prioritetet e domosdoshme për të mbetur konkurrues në afat të shkurtër dhe ato janë:

- Rritja e Arsimit, Cilësisë, Universitetit dhe Studimeve,
- Nxitja e Ekselencës Kërkimore,
- Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e programeve dhe gradave,
- Mbështetja e misionit,
- Të mësuarit për një botë me diversitet,
- T'i shërbejmë Kosovës, komunitetit dhe të diplomuarve tanë, dhe
- Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike.

Kurse, tetë fushat strategjike të fokusit dhe nismat strategjike janë:

1. Mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi,
2. Akreditimi dhe kontrollimi i cilësisë,
3. Nivelet/Programet e kërkuara nga tregu,
4. Zhvillimi i burimeve njerëzore,
5. Zhvillimi i sistemit,
6. Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave,
7. Zhvillimi i infrastrukturës, dhe
8. Globalizimi/Ndërkombëtarizimi.

Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës «Hasan Prishtina» 2020-2022

Ky Plan Strategjik është pasardhës i Planit Strategjik që sapo e elaboruam në pika të shkurtra dhe kësisoj në një masë të madhe paraqet vijimësinë e objektivave strategjike dhe prioriteteteve të përcaktuara nga Universiteti i Prishtinës. Identifikimi i këtyre objektivave strategjike nga Universiteti i Prishtinës është bërë duke e pasur një synim të qartë: avancimin e pozitës konkurruese përmes ofrimit të shërbimeve cilësore, pa dallim, për nevojat e popullatës së Kosovës, por edhe më gjerë.

Plani Strategjik 2020-2022 i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” është plan institucional me elemente të planifikimit strategjik dhe të planifikimit operacional. Lidhur me këtë Plan, duhet theksuar se mungon qasja e unifikuar në nivel institucional: në njërën anë është hartuar Plani i Veprimit 2020-2022 i unifikuar dhe njëkohësisht, kërkohet nga njësitë akademike që të hartojnë planet e veta operationale: “Sipas Planit Strategjik, njësitë administrative dhe akademike pritet që të zhvillojnë plane për zbatimin e iniciativave, objektivave dhe detyrave brenda njësive të tyre” (PSUP, fq. 21). Një qasje e këtillë mund të sjellë dyfishim të përpjekjeve, ngatërrim të kompetencave dhe vështirësi në monitorimin e zbatimit të Planit. Në të vërtetë, në momentin që është hartuar plani i veprimit nga ana e rektoratit, atëherë njësitë mund ta kenë të vështirë të kuptojnë se çfarë planifikimi tjetër mund të kërkohet prej tyre. Për ilustrim, zhvillimi i personelit parashihet në planin qendror të veprimit, por mund të rezultojë edhe masë e veçantë e planeve operationale të njësive akademike. Pos kësaj, këto masa pastaj mund të dallojnë shumë prej një njësie në tjetrën, gjë që mund të sjellë qasje diverse dhe jokohërente të zhvillimit të personelit në nivel institucional.

Prioritetet janë si në vijim:

- Rritja e cilësisë në arsim dhe kërkim shkencor/artistik,
- Nxitja e hulumtimeve kërkimore shkencore/artistike,
- Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e programeve,
- Mbështetja e zhvillimit të UP-së,
- Diversiteti si proces,
- T’i shërbejmë Kosovës, diversitetit dhe të diplomuarve tanë, dhe
- Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike dhe shërbimeve studentore të fakulteteve të UP-së.

Ndërsa fushat strategjike të këtij Plani Strategjik janë:

1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia,
 2. Puna kërkimore shkencore/artistike,
 3. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi,
 4. Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu,
 5. Zhvillimi i burimeve njerëzore,
 6. Zhvillimi i sistemit të IT-së,
 7. Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave,
 8. Zhvillimi i infrastrukturës, dhe
 9. Globalizimi/Ndërkombëtarizimi.
-

Siç u përmend edhe më lart, sipas Planit Strategjik, njësitë administrative dhe akademike pritet që të zhvillojnë plane për zbatimin e iniciativave, objektivave dhe detyrave brenda njësive të tyre. Pikërisht, për zhvillimin apo jo të këtyre planeve dhe implementimin e tyre në praktikë nëpër disa njësi akademike, do të flasim në kapitujt vijues.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të Planit, gjatë tryezës së organizuar (21 shtator 2021) për të diskutuar versionin punues të këtij raporti, përfaqësuesit e UP-së treguan se kishin krijuar mekanizmin dhe instrumentet përkatëse për përcjelljen dhe monitorimin e zbatimit të Planit. Një karakteristikë e këtij Plani është se ai nuk dallon shumë as në strukturë, as në përmbajtje, nga Plani Strategjik 2017-2019 i po këtij Universiteti. Kjo mund të shpjegohet me shfaqjen e pandemisë COVID-19 (vitet 2020-2021), mirëpo në të njëjtën kohë tregon për mungesë të një qasjeje më të mirëfilltë në planifikimin strategjik e zhvillimor nga ana e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Gjatë krahasimit të aspekteve kryesore të këtyre tre dokumenteve thelbësore për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovës vërehen shpërputhje thelbësore në mes të këtyre tre dokumenteve në makrostrukturë dhe në mikrostrukturë, në terminologji dhe në konceptet e përdorura, si dhe në qasjen e përdorur për planifikim.

Në makrostrukturë, Plani Kombëtar Zhvillimor është i ndërtuar mbi bazën e programit, duke vënë në plan të dytë vizionin, misionin dhe objektivat strategjikë. Dokumenti i analizuar nga ekipi hulumtues nuk përfshin buxhetin dhe planin e detajuar të veprimit, që janë elemente themelore të një plani strategjik. Nga ana tjetër, PSAK-u i ka të gjitha elementet e një planifikimi strategjik, përfshirë edhe bazën e të dhënave dhe vlerësimin e gjendjes.

Ndërkaq, Plani Strategjik (2020-2022) i UP-së, përcakton qëllimet e përgjithshme dhe objektivat strategjike dhe njëkohësisht (a) duke ua lënë njësive akademike realizimin e planeve operacionale për zbatimin e Planit dhe (b) duke e hartuar Planin e Implementimit për tri vite! Njëkohësisht, nga këto tre dokumente, vetëm PSAK-u përfshin Analizën Paraprake të Gjendjes, Kornizën e Monitorimit dhe të Vlerësimit të Performancës, Buxhetin e Detajuar dhe të Analizuar, Vlerësimin e Rreziqeve, si dhe Strategjinë e Komunikimit.

Në nivelin e mikrostrukturës në Planin e UP-së mungon përshkrimi i masave strategjike. Duhet kujtuar se pikërisht përshkrimi i masave përcakton edhe strategjinë që përdoret për t'i arritur objektivat, duke e bërë dallimin në mes të rrugëve (lexo: strategjive) të ndryshme të aplikuara nga të gjitha rrugët në dispozicion të institucioneve për arritjen e objektivave. Terminologjia është dallimi i tretë kryesor në mes të këtyre tre dokumenteve, pasi që në rastin e Planit Kombëtar kemi të bëjmë me qëllime, fusha të intervenimit dhe projekte konkrete, për dallim prej gjuhës koncize dhe të strukturuar mirë të PSAK-ut të hartuar nga MASHTI (vizion, mision, caqe konkrete, objektiva strategjike, rezultate të pritura, masa dhe aktivitete). Terminologjia e përdorur nga UP-ja ngatërron deri diku formulimin e qëllimeve, synimeve, objektivave dhe rezultateve.

Në fund, mund të thuhet se PSAK-u zbaton qasje më të standardizuar për hartimin e planeve strategjike, si në aspektin e procesit (gjithëpërfshirës dhe i strukturuar), strukturës (prej vizionit e deri te aktivitetet) dhe të terminologjisë së pranuar ndërkombëtarisht për planifikimin sektorial. Në këtë kontekst, është e këshillueshme që Zyra e ZKM-së për Planifikim Strategjik dhe dokumentet e ZKM-së të publikuara në uebfaqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mund të jenë mekanizmat kryesor për standardizimin e qasjes dhe të procesit të planifikimit strategjik.

INDIKATORËT

Ekipi hulumtues e ka shqyrtuar zbatimin e planeve strategjike në fushën e arsimit të lartë, duke u nisur nga pesë indikatorë kryesorë:

- transparenca dhe llogaridhënia,
- puna shkencore,
- gjithëpërfshirja,
- ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës, dhe
- akreditimi.

Në vijim, këta indikatorë trajtohen veç e veç, duke parë zbatimin e tyre në dokumentet strategjike të niveleve të ndryshme, relevante për arsimin e lartë.

Transparenca dhe llogaridhënia

Ngritja e cilësisë në arsimin e lartë është e lidhur ngushtë me transparencën dhe llogaridhënien. Këto janë dy procese që e rrisin efikasitetin e punës brenda një universiteti. Transparenca dhe llogaridhënia vlerësohen si dy faktorë shumë të rëndësishëm, që sigurojnë se arsimit i lartë i një vendi po shënon përparim dhe po e zë hapin në raport me konkurrencën.

Edhe pse është Strategji shumë gjithëpërfshirëse dhe jo e fokusuar kryesisht në arsim, e aq më tepër në arsimin e lartë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim në shumë vende përmend transparencën dhe llogaridhënien, sidomos në lidhje me fushën e prokurimit publik dhe arsimit. SKZH-ja e sheh si të nevojshme ndërhyrjen në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor. Sepse, siç thuhet po aty, kjo do të mundësojë që shkollat dhe mësimdhënësit të japin llogari si dhe të shpërblehen për cilësinë e punës, gjë që do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së arsimit. SKZH-ja konsideron se sistemi arsimor në Kosovë vuan nga mungesa e mekanizmave efektivë të vlerësimit të suksesit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Si shkak për këtë, ndër shumë shkaqe të tjera, konsiderohet të jetë mungesa e autonomisë dhe llogaridhënies së autoriteteve akredituese për performancën e tyre. Prandaj, si aktivitet konkret vlerësohet përmirësimi i cilësisë së autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve të akredituara përmes zhvillimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të Autoriteteve Akredituese (AAK dhe AKK). SKZH-ja vlerëson se rritja e praktikave të llogaridhënies dhe sigurimit të cilësisë do të rezultojë me performancë më të mirë të sistemit arsimor dhe për rrjedhojë, edhe me rritjen e aftësive dhe shkathtësive të fuqisë punëtore.

Për shkak të rëndësisë së tyre, transparencja dhe llogaridhënia janë konsideruar si objektiva strategjike të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 (të hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit), konkretisht menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe llogaridhënie. Sfidat të cilat konsiderohen në kuadër të kësaj objektive strategjike përfshijnë:

- Kapacitetet e pamjaftueshme në nivel qendror, komunal dhe të shkollës,
- Mungesën e koherencës në fushën e legjislacionit dhe politikave,
- Mungesën e profesionalizmit menaxherial dhe autonomisë shkollore,
- Vendimmarrjen jo të bazuar në të dhëna, dhe
- Kushtet jo të mira dhe mjedisin jo të përshtatshëm për mësim cilësor.

Mund të thuhet që ky trajtim kaq prioritar për këta dy indikatorë është edhe si rrjedhojë e mospërbushjes së disa prej masave të parapara në Planin Strategjik të Arsimit të Lartë 2011-2016. Kujtojmë që në gjetjet kyçe të vlerësimit të PSAK-ut 2011-2016 shpjegohet qartë se mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë dhe llogaridhënies mbesin të pazhvilluara dhe procesi i zbatimit të kurrikulës së re është larg nga përbushja e afatit të përcaktuar në planifikim¹. Por vlerësohet se pagat e mësimdhënësve janë rritur dhe janë krijuar parakushte për joshjen e mësimdhënësve të kualifikuar dhe për ta përmirësuar llogaridhënien e tyre². Megjithatë u përmend llogaridhënia financiare, duhet thënë që Kosova deri në momentin kur është hartuar PSAK 2017-2021, nuk e ka pasur të zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxit efektivitetin dhe llogaridhënien, përkundër faktit që korniza ligjore e arsimit të lartë përcakton zhvillimin e mekanizmave efektive për financim të bazuar në performancë³.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim efektiv dhe llogaridhënës të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle,
- Përcaktimi i standardeve profesionale për rekrutim dhe mekanizmave për menaxhimin e karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore,
- Zbatimi i një mekanizmi funksional të financimit të arsimit parauniversitar që i kontribuon zhvillimit të shkollës,
- Përgatitja dhe publikimi i raporteve të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzimi i këtyre analizave në politikëbërje,

¹Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, MASHTI, fq. 18.

²Po aty.

³Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, MASHTI, fq. 29.

- Harmonizimi dhe kompletimi i legjislacionit për tërë sektorin e arsimit parauniversitar për të reflektuar ndryshimet në legjislacion dhe politikat e tjera,
- Krijimi i mjediseve të sigurta nga shkollat, miqësore dhe të shëndetshme për të gjithë,
- Ndërtimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të objekteve shkollore që i kontribuon krijimit të mjediseve të përshtatshme për mësim, dhe
- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore përmes ndërtimit, rinovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor.⁴

Indikatorët të cilët do të shërbejnë si matës për arritjen e këtij objektiv, sipas PSAK 2017-2021 janë: përqindja e anëtarëve të trajnuar të këshillave drejtues të shkollave, përqindja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të trajnuar të shkollave, numri i personelit në DKA të trajnuar për udhëheqje mësimore, numri i nxënësve në shkollat fillore që mësojnë në një ndërrim, hapësira shkollore për kokë nxënësi, numri i shkollave të pajisura me dollapë individuale për nxënësit, numri i shkollave që do të pajisen me inventar, numri i shkollave që do të pajisen me pako sportive, numri i institucioneve parashkollore që do të ndërtohen, rinovimi i objekteve shkollore, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ndërtimi i objekteve për institucionet e arsimit të lartë, trajnimi i personelit menaxhues dhe mësimdhënës në shkolla për sigurinë dhe shëndetin në shkollë, numri i shkollave që pajisjen me pako të ndihmës së parë, numri i personelit të MASHTI-t të trajnuar për planifikim, politikëbërje dhe monitorim, numri i rregulloreve dhe procedurave të miratuara për komunikim efektiv, numri i rrjeteve të shkollave të themeluara, numri i planeve zhvillimore komunale të miratuara, përqindja e shkollave që kanë kodin buxhetor dhe menaxhojnë buxhetin e tyre, numri i politikave mbi menaxhimin e të dhënave të SMIA, numri i personelit të trajnuar për futjen dhe shfrytëzimin e të dhënave të SMIA⁵.

Meqenëse fokusi kryesor i këtij hulumtimi është arsimit i lartë, vërejmë se për arsimin e lartë ky objektivi parasheh:

- në kuadër të rezultatit «Përgatitja dhe publikimi i raporteve të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzimi i këtyre analizave në politikëbërje» ngritjen e kapaciteteve për shfrytëzuesit e të dhënave nga shkollat, DKA-të, niveli qendror dhe universitetet.

⁴Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, MASHTI, fq. 53.

⁵Plani i Veprimtari i PSAK 2017 – 2021, MASHTI, fq.10.

Ngritja e këtyre kapaciteteve duhet të ndërlihet me procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe futjes së të dhënave në sistem dhe me theks të veçantë përdorimi i tyre në vendimmarrje⁶. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë trajnimi i përdoruesve të të dhënave të SMIA⁷,

- në kuadër të rezultatit «Ndërtimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të objekteve shkollore që i kontribuon krijimit të mjediseve të përshtatshme për mësim» zhvillimin e normave dhe standardeve për projektimin e objekteve arsimore për të gjitha nivelet⁸. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë hartimi i normave dhe standardeve për projektimin e objekteve shkollore⁹. Gjithashtu, në kuadër të po këtij rezultati, PSAK parasheh avancimin e databazës për ndërtesat arsimore¹⁰,
- në kuadër të rezultatit «Përmirësimi i infrastrukturës arsimore përmes ndërtimit, rinovimit, zgjerimit dhe pajisjes së institucioneve arsimore me mjete adekuate për procesin mësimor» zgjerimin dhe përmirësimin e mjediseve mësimore në institucionet e arsimit të lartë¹¹. Në kuadër të këtij aktiviteti, është paraparë që në vitet 2018, 2019 dhe 2020 të ndërtohet nga një objekt për institucionet e arsimit të lartë¹².

Gjithashtu, transparenca dhe llogaridhënia janë pjesë kyçe edhe e Planeve Strategjike të Universitetit të Prishtinës (2017-2019 dhe 2020-2022). Fillimisht, transparenca dhe llogaridhënia përmenden në kuadër të fushës strategjike «Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave». Thënë më konkretisht, aty parashihet hartimi dhe zbatimi i financave superiore dhe sistemeve buxhetore (politikat, softuerë, proceset, trajnimi dhe shfrytëzimi) për përmirësimin e menaxhimit të Universitetit dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies¹³. Në kuadër të kësaj iniciative strategjike, parashihen disa objektiva:

-
- Arritja e raportimit mujor të buxhetit,
 - Zhvillimi i sistemeve të afta për buxhet në kohë reale dhe të sistemeve financiare të qasjes nga ana e stafit ekzekutiv,
 - Arritja e llogaridhënies dhe transparencës në të gjitha çështjet financiare,
 - Përmirësimi i përditshëm i menaxhimit të institucionit dhe mjeteve të ndara, dhe
 - Përmirësimi i planifikimit dhe ekzekutimit.¹⁴
-

⁶Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHTI, fq. 57 – 58.

⁷Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHTI, fq.13.

⁸Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHTI, fq. 59.

⁹Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHTI, fq.14.

¹⁰Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHTI, fq. 60.

¹¹Po aty.

¹²Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHTI, fq.16.

¹³Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017 – 2019, UP, fq. 17.

¹⁴Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017 – 2019, UP, fq. 54.

Kurse, si detyra apo aktivitete parashihen:

- Zhvillimi i një pulti për përdorim të brendshëm nga ana e drejtuesve që përfshin treguesit financiarë,
 - Marrja, ekzekutimi dhe trajnimi i softuerëve të rinj financiarë,
 - Krijimi dhe trajnimi i stafit për politikat financiare të UP-së,
 - Zhvillimi i formave të automatizuara,
 - Reformimi i procesit buxhetor me standardet evropiane dhe/ose ISO9000, etj.,; dhe
 - Themelimi i një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit vjetor që përfshin zhvillimin e buxhetit nga poshtë-lart.¹⁵
-

Ndërsa, si masa për këto aktivitete, janë llogaritur të poshtëshënuarat:

- Arritja e zbatimit brenda afateve kohore,
- Vendosja e masave për shfrytëzimin e buxhetit dhe përmirësimin (rënies) të strukturës së kostos me 5%,
- Matja e përdorimit të sistemeve të automatizuara dhe pultit, dhe
- Masa kundër treguesve të synuar financiarë për performancën e zyrtarëve financiarë dhe veprimeve ekzekutive.¹⁶

Duhet thënë që shumica nga këto aktivitete/masa ripërsëriten edhe në Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës 2020 – 2022.

Duhet thënë që shumica nga këto aktivitete/masa ripërsëriten edhe në Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës 2020 – 2022.

¹⁵Po aty.

¹⁶Po aty

Puna shkencore

Puna kërkimore radhitet në mesin e dhjetë dimensioneve kryesore të Procesit të Bolonjës, kurse lidhja e integruar mes arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është veçori dalluese e universiteteve moderne. Puna kërkimore është nga komponentët më të rëndësishëm të çdo universiteti dhe publikimet janë ndër tre komponentët kryesorë të angazhimit të personelit akademik.

Edhe pse nuk është prioritet i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, puna kërkimore-shkencore nuk kalon pa u përmendur as aty. Meqenëse, siç e kemi thënë më lart, SKZH-ja është e orientuar drejt zhvillimit ekonomik, në masën «Kalimi i NVM-ve¹⁷ në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar», konkretisht si aktivitete të kësaj mase parasheh krijimin e një skeme për mbështetjen e inovacionit që do të siguronte stimuj (grante korrespondente) për investimet e NVM-ve në hulumtime dhe kërkime shkencore. Kjo skemë është paraparë të jetë pjesë e Fondit të Punësimit dhe Zhvillimit¹⁸. Ky Fond, sipas Programit të Qeverisë së Kosovës 2015-2018, është konsideruar të jetë mjeti kryesor për të adresuar nivelin e lartë të papunësisë (përmes krijimit të vendeve të reja të punës), të ulë deficitin e vazhdueshëm tregtar, të rrisë zhvillimin e inovacionit në sektorin privat (përmes rritjes së shkathtësive të fuqisë punëtore, tërheqjes së investimeve të huaja dhe hulumtimeve shkencore) si dhe të ulë varësinë në remitenca (përmes gjenerimit të të ardhurave të brendshme)¹⁹.

Siç u tha më lart, kërkimi shkencor është tregues kyç lidhur me cilësinë e arsimit të një vendi, kryesisht nivelit universitar të arsimit. Nuk mund të ketë një Universitet cilësor, i cili njëkohshëm është pasiv në fushën e kërkimit shkencor. Universitetet moderne, përveçse vatra të mësimdhënies, një pjesë të mirë të aktivitetit dhe fokusit të tyre ia kushtojnë kërkimit shkencor. Prandaj, një gjë e tillë duhet të merret më seriozisht edhe nga institucionet përgjegjëse në vendin tonë, edhe nga vetë Universiteti i Prishtinës (si dhe universitetet e tjera publike në Kosovë). Kujtojmë që sipas një raporti të Organizatës për Rritjen e Cilësisë në Arsim, del se nga profesorët që i kanë publikuar CV-të e tyre në faqen e Universitetit evidentohen si punime të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë apo korrespondent, gjithsej 1,838 punime.

¹⁷NVM - Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme.

¹⁸Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021, ZKM, fq. 33.

¹⁹Po aty, fq. 54.

Një rritje domethënëse prej 369 punimesh në krahasim me vitin 2019 kur ishin evidentuar 1,469 punime dhe një diferencë prej 1,091 sosh në krahasim me 2017 kur ishin evidentuar 747 punime, kur dhe ka filluar ky hulumtim.²⁰

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 e trajton kërkimin shkencor me mjaft prioritet. Atij i jepet vëmendja e duhur në kuadër të Objektivit Strategjik «Arsimi i Lartë (AL)». Aty parashihet ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit. PSAK 2017-2021 vlerëson se financimi i shtuar i veprimtarisë kërkimore-shkencore mund të sjellë ngritje të kapaciteteve hulumtuese në fushën e edukimit, ndërkaq kjo mund të rezultojë me hulumtime të ndryshme që dalin me rekomandime të reja praktike për adresimin e problemeve në arsim²¹. Ndërsa, kur bëhet vlerësimi i PSAK-ut paraprak thuhet se shpenzimet e qeverisë në kërkimin shkencor janë shumë të ulëta (0.1% e BPV-së)²². Gjithashtu, mosinkurajimi i punës kërkimore-shkencore në IAL konsiderohet si njëra nga sfidat kryesore të arsimit të lartë. PSAK-u konsideron se puna kërkimore-shkencore nuk është plotësisht e integruar në aktivitetet e zakonshme të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare të stafit të institucioneve të arsimit të lartë mbetet jashtëzakonisht i vogël. Rritja e numrit të publikimeve shkencore të stafit të institucioneve të arsimit të lartë në revista të indeksuara ndërkombëtare kërkon mbështetjen e hulumtuesve në publikimin e punimeve dhe prezantimin e rezultateve shkencore në konferenca ndërkombëtare. Krahas kësaj, nevojitet të përmirësohet mjedisi jo i përshtatshëm për punë kërkimore-shkencore duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës së përshtatshme fizike, laboratorëve dhe pajisjeve jofunksionale dhe mungesën e qasjes në burime shkencore në biblioteka elektronike²³.

Rezultatet e pritshme në kuadër të objektivit të lartpërmendur konsiderohen të jenë:

- Raporti staf akademik-student në IAL është të paktën 1:40,
- Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksionalë,
- Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë janë plotësisht funksionalë,

²⁰Integriteti akademik në Universitetin e Prishtinës, ORCA, fq.12.

²¹Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHTI, fq. 18.

²²Po aty, 19.

²³Po aty, 94.

- Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike,
- Deri në vitin 2019, Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim të Lartë (SMIAL) është plotësisht funksional,
- Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim dhe këshillim në karrierë janë funksionale në IAL,
- Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% për çdo vit,
- Deri në vitin 2018 është rishikuar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për arsimin e lartë,
- Deri në vitin 2020 fillon zbatimi i formulës së financimit të arsimit të lartë në bazë të performancës,
- Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të IAL, dhe
- Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.²⁴

Indikatorët që do të shërbejnë si matës për arritjen e këtij objekti janë: numri i studentëve për 100.000 banorë, përqindja e personave të moshës 30-34 vjeç me arsimim të lartë, indeksi i paritetit gjinor në arsimin e lartë, shkalla e “mbijetesës”, përpjesëtimi profesorë-studentë, rritja e numrit të punimeve në revista të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, numri i studentëve të regjistruar në programet e doktoratës në vend, numri i studentëve që përfitojnë bursa për vijimin e studimeve të doktoratës jashtë vendit, numri total i orëve të realizuara të zhvillimit profesional, numri i studentëve në programet e nivelit EQF 5, numri i muajve të mobilitetit për stafin akademik, numri i muajve të mobilitetit për studentë, mobiliteti mësimor në arsimin e lartë, përqindja e programeve studimore që zhvillohen në gjuhën angleze.²⁵

Meqenëse, në këtë pikë jemi të fokusuar vetëm me kërkimin shkencor e jo me tregues tjerë të arsimit të lartë, të listuara mëposhtë janë masat që parashihen të ndërmerren:

- në kuadër të rezultatit «Mekanizmat për zhvillim profesional të stafit akademik në IAL janë plotësisht funksionalë» themelimi dhe funksionalizimi i zyrave për përsosmëri të mësimdhënies²⁶.

²⁴Po aty, 96.

²⁵Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHT, fq. 41.

²⁶Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHT, fq.97.

- Ndërkaq, në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë edhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale për stafin e zyrave për përsosmëri të mësimdhënies, konkretisht organizimi i një seminari treditör në Kosovë me ekspertë ndërkombëtarë²⁷;
- në kuadër të rezultatit «Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike» vlerësimi i nevojave të infrastrukturës për mësim dhe punë kërkimore-shkencore, mbështetja institucionale për zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore, hartimi i planeve për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të laboratorëve²⁸. Ndërsa në kuadër të këtyre aktiviteteve është paraparë hapja e tre laboratorëve të rinj për mësim dhe punë kërkimore-shkencore në vitin 2018, në vitin 2019 hapja e dy laboratorëve të tillë. Gjithashtu, hartimi i rregullores për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve të laboratorëve, trajnimi i stafit akademik dhe administrativ përgjatë viteve 2018-2020 (një seminar në vit) për shfrytëzimin e laboratorëve,²⁹
- në kuadër të rezultatit «Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare nga stafi akademik rritet për 25% në çdo vit» analiza e aktiviteteve hulumtuese të stafit akademik, zhvillimi i planeve të veprimit për veprimtari kërkimore-shkencore, mbështetja e publikimit të punimeve shkencore në revista të indeksuara dhe prezantimi i rezultateve në konferenca ndërkombëtare, krijimi i regjistrit kombëtar i hulumtuesve shkencorë³⁰. Ndërsa, në kuadër të këtyre aktiviteteve është paraparë vlerësimi i aktiviteteve hulumtuese të stafit akademik në IAL publike, hartimi i Programit Kombëtar të Shkencës (PKSH), konkretisht organizimi i tri punëtorive, hartimi i planeve të veprimit të IAL publike për veprimtari kërkimore-shkencore, konkretisht organizimi i tri punëtorive, mbështetja për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare (50 grante, përfshirë shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit dhe kuotimit) përgjatë viteve 2017-2021, mbështetja e hulumtimeve dhe publikimit të punimeve shkencore (50 grante për mobilitete, 10 grante për botime, 20 grante për projekte të vogla të hulumtimit) përgjatë viteve 2017-2021, zhvillimi i databazës së hulumtuesve shkencorë³¹, dhe
- në kuadër të rezultatit «Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore» mbështetja për aplikim në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor, si dhe promovimi i programeve evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor³².

²⁷Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHT, fq. 42.

²⁸Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 - 2021, MASHT, fq.98.

²⁹Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHT, fq. 44.

³⁰Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 - 2021, MASHT, fq.100

³¹Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHT, fq. 46-47.

³²Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 - 2021, MASHT, fq.102.

Ndërsa, në kuadër të këtyre aktiviteteve është paraparë krijimi i fondit për mbështetjen e projekta aplikimeve në programet evropiane Erasmus+ dhe Horizon2020 (10 grante) përgjatë viteve 2017-2021 dhe organizimi i 10 seanceve informative (2017-2021) për stafin akademik dhe studentët lidhur me informimin mbi mundësitë, kushtet dhe aspektet financiare të aplikimit në programet e kornizës së BE-së³³.

Kërkimi shkencor, gjithashtu zë një pjesë relativisht të rëndësishme edhe në Planet Strategjike të Universitetit të Prishtinës. Ai përmendet që në Misionin e Universitetit, për të vazhduar më tej edhe në fushat strategjike të fokusit dhe iniciativat strategjike të Planit Strategjik të UP-së, siç janë: mësimdhënia, kërkimi, shërbimi në kuadër të së cilës parashihet rritja e rezultateve kërkimore të stafit akademik në revista konkurruese të pranuara ndërkombëtarisht në fushën e tyre dhe akreditimi dhe kontrollimi i cilësisë në kuadër të së cilës parashihet krijimi i një fondi të bursave për vizita kërkimore afatshkurta jashtë vendit, rritja dhe përmirësimi i rezultateve kërkimore në UP.

Në kuadër të fushës strategjike të fokusit «Mësimdhënia, kërkimi, shërbimi» përmenden këto iniciativa strategjike që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor³⁴:

Iniciativa strategjike: Të rritet rezultati i kërkimit të fakultetit në revista konkurruese ndërkombëtarisht të aprovuara në fushat e tyre dhe të sigurohet zhvillim dhe përkrahje profesionale në metodologjinë e kërkimit, analizës statistikore, shkrimit në revista dhe kostos së publikimit sipas nevojës, dhe Qëllimi 1: Të implementohet Qendra për Kërkim me personel dhe fonde.

Detyrat/aktivitetet:

-
- Trupi pedagogjik do të mbajë trajnim të detyrueshëm për zhvillim të hulumtimit,
 - Trupi pedagogjik do të themelojë dhe do të planifikojë si do ta përmbushë standardin ndërkombëtar për disiplinën e tyre, dhe
 - Të zhvillohet bashkëpunimi në fushën e kërkimit dhe mësimdhënies me kolegë të UP-së dhe me universitete tjera globale.
-

³³Plani i Veprimit i PSAK 2017 – 2021, MASHT, fq.50.

³⁴Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës, UP, fq. 20 – 21.

Masat:

-
- Të përbushen afatet/standardet e vendosura të trajnimit,
 - Të vendosen standarde, dhe
 - Të matet produktiviteti bazë i rezultatit të kërkimit dhe të maten të arriturat (të maten në krahasim me standardet globale në secilën disiplinë).
-

Qëllimi 2: Përgjatë 5 vitesh të rritet publikimi i verifikueshëm i të gjithë trupit pedagogjik të rregullt, në mënyrë që të mund të konkurojnë me standardet globale për fakultet në fushat e tyre përkatëse të studimit.

Qëllimi 3: Të ndërtohet kompetencë kërkimore, në mënyrë që trupi pedagogjik të mësojë dhe të modelojë kërkime për studentët e tyre.

Masat:

-
- Të përbushen afatet/standardet e vendosura të trajnimit,
 - Të vendosen standarde, dhe
 - Të matet produktiviteti bazë i rezultatit të kërkimit dhe të maten të arriturat (matjet të bëhen në krahasim me standardet globale në secilën disiplinë).
-

Ndërsa në kuadër të fushës strategjike të fokusit "Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë" përmendet iniciativa strategjike «Përmirësimi dhe rritja e rezultateve hulumtuese në UP», që i ka këta objektivë³⁵:

-
- Inkurajimi i përfshirjes së kapaciteteve të diasporës në kërkime shkencore/arte dhe aktivitetet zhvilluese, dhe
 - Hartimi dhe zbatimi i planeve trevjeçare për aktivitetet e kërkimeve shkencore/të artit në UP.

Ndërsa Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2020-2022, në kuadër të fushës strategjike «Puna kërkimore shkencore/artistike» i parasheh këto objektiva³⁶:

- Rritja e rezultateve kërkimore-shkencore/artistike të stafit akademik në revista konkurruese të pranuar ndërkombëtarisht në fushën e tyre,
- Sigurimi i zhvillimit profesional dhe mbështetjes në metodologjinë e hulumtimit, analiza statistikore, shkrimit për revista, ditarë dhe koston e publikimit sipas nevojës,

³⁵Po aty, fq. 36 dhe 39.

³⁶Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2020 – 2022, UP, fq. 17

- Rritja e mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve që janë burim i të hyrave të universitetit, dhe
 - Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.
-

Gjithëpërfshirja

Studime të shumta ndërkombëtare (përfshirë ato të OECD-së dhe të UNESCO-s) tregojnë se sistemet arsimore më gjithëpërfshirëse janë më të suksesshme në zhvillimin e kompetencave të fëmijëve dhe të rinjve. Kjo është konfirmuar edhe nga rezultatet e testit ndërkombëtar PISA, ku rezultatet më të mira tregohen nga vendet si Finlanda, Japonia, Singapori, Koreja e Jugut, e të tjera që ofrojnë cilësi dhe shërbime të njëjta në të gjitha pjesët e vendit. Nëpërmjet zbatimit të parimit të gjithëpërfshirjes në arsim, trasohet një rrugë drejt emancipimit shoqëror duke i përfshirë të gjithë pa asnjë dallim gjinor, racor, socio-ekonomik, e të tjerë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 gjithëpërfshirjen e sheh si të domosdoshme jo vetëm për shkak se është parakusht për drejtësi shoqërore dhe kohezion, por edhe për shkak se si e tillë ajo mundëson rritje më të madhe dhe më të qëndrueshme ekonomike.³⁷

Sa i përket Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, kur përmendet gjithëpërfshirja kryesisht mendohet për nivelet më të ulëta të arsimit, e më pak për arsimin e lartë. **Si sfida kryesore lidhur me gjithëpërfshirjen përmenden³⁸:**

- Shkalla e ulët e përfshirjes në edukimin parashkollor,
- Mosfunksionimi i sistemit të licensimit dhe monitorimit të institucioneve private të edukimit parashkollor,
- Përfshirja e pamjaftueshme në arsim e fëmijëve me nevoja të veçanta,
- Përfshirja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, dhe
- Fenomeni i braktisjes së shkollimit ende i pranishëm.

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja paraqesin objektivin e parë strategjik të këtij Plani Strategjik. Te ky objektivi strategjik si problem qendror paraqitet pjesëmarrja e ulët në edukimin parashkollor.

³⁷Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021, ZKM, fq. 5.

³⁸Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHT, fq. 22.

Rruga më e mirë për zgjidhjen e këtij problemi do të ishte ndërtimi i një numri të konsiderueshëm të institucioneve parashkollore të specializuara që do të implikonte rritjen e shpenzimeve kapitale dhe hapjen e qindra vendeve të punës në sektorin publik³⁹. Rezultatet e pritshme në kuadër të këtij objektiv janë:

-
- Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0-5,
 - Të gjithë fëmijët e moshës pesëvjeçare përfshihen në edukimin cilësor parafillor,
 - 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar,
 - Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë për 20%,
 - Përfshihen të gjithë fëmijët e riatdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimin në diasporë,
 - Ekzistojnë mekanizma dhe programe për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta në fusha akademike, kreative e artistike, dhe
 - Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor.⁴⁰

Në anën tjetër në Planet Strategjike të Universitetit të Prishtinës 2017-2019 dhe 2020-2022 nuk ka ndonjë objektiv strategjik apo masë konkrete për gjithëpërfshirje të të gjitha grupeve të cënueshme në vend, përfshirë grupet etnike, personat me aftësi të kufizuara, e të tjerë.

³⁹Po aty, fq. 40.

⁴⁰Po aty, fq. 43.

Ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës

Ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës është një kërkesë e shekullit XXI. Nëse në të kaluarën, për arsye të ndryshme, përfundimi i shkollimit, e veçanërisht shkollimit universitar, e ka siguruar një vend të punës për të diplomuarin, kjo gjë, për shkak të shumë faktorëve, tani ka ndryshuar. Prandaj, është më se e rëndësishme që fokusi i të gjithë aktorëve relevantë të jetë te kjo lloj ndërlidhjeje.

Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit të arsimit dhe tregut të punës përmendet edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 dhe si aktivitete konkrete të kësaj mase llogariten të jenë:

- Përshpejtimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale, në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe me Sistemin e rishikuar Kombëtar për Klasifikimin e Profesioneve,
- Përcaktimi i fushave me prioritet më të lartë në AAP duke u konsultuar me politikat zhvillimore të Kosovës dhe sektorët prioritarë. Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë në një format modular, sipas fushave prioritare të AAP-së si dhe realizimi i programit për trajnimin e mësimdhënësve të AAP-së për ata sektorë, bazuar në standardet e profesionit,
- Zbatimi i sistemit pilot i kombinuar i AAP-së me elemente të mësimin të dyfishtë (kombinimi i të mësuarit në shkolla dhe në ndërmarrje) duke filluar me fushat prioritare në AAP dhe duke ndjekur kurrikulën bërthamë. Do të koordinohet sistemi i subvencionimit të pagave me fushat prioritare, në mënyrë që të mundësohet integrimi më i mirë i të diplomuarve të AAP-së në tregun e punës,
- Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar të Parashikimit të Nevojave për Shkathtësi. Kjo do të bëhet duke e siguruar ndërlidhjen me sistemin e orientimit në karrierë brenda shkollave dhe shërbimet e punësimit/të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe

- Ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë përmes qasjes së specializimeve të mençura në përputhje me strategjinë Evropa 2020. Kjo nënkupton investime publike dhe private për hulumtim dhe zhvillim (R&D) në një numër të caktuar sektorësh industrialë.⁴¹

Kurse, PSAK 2017 – 2021 ndërlidhjen e tregut të punës me sistemin e arsimit e shih kryesisht si pjesë të objektivit strategjik «Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi i të Rriturve». Ndërkaq, Universiteti i Prishtinës në Planet e veta Strategjike i kushton një vëmendje të veçantë këtij indikator. **Në kuadër të fushës strategjike të PSUP 2017-2019 "Nivele/programe të kërkura nga tregu" renditen këto iniciativa strategjike, së bashku me objektivat strategjike, aktivitetet dhe masat e tyre**⁴²:

- Të implementohen programet e diplomës në përputhje me nevojat e tregut, së bashku me iniciativën tjetër strategjike; të bëhen analiza të tregut për të identifikuar se cilat programe janë relevante me nevojat e tregut; të sigurohet udhëzim dhe strukturë se çfarë diplomash nevojiten për të plotësuar nevojat e punësimit në Kosovë. Si aktivitete janë paraparë të jenë: krijimi i komiteteve këshilluese nëpër industri specifike brenda kornizës së njësive akademike të UP-së, bashkëpunimi me Odën Ekonomike të Kosovës, institucionalizimi i programeve të praktikës si pjesë e kurrikulave, baza ligjore, e të tjerë. Ndërsa, disa nga masat e këtyre aktiviteteve që janë paraparë janë: krijimi dhe miratimi i bazës ligjore për themelimin e grupeve këshilluese, krijimi i një komiteti këshillues nga secili fakultet, përkrahja/trajnimi i secilit fakultet për organizimin e praktikës si pjesë e kurrikulës, implementimi i praktikës nga secili program studimi si pjesë e kurrikulës së secilës lëndë, implementimi i programeve profesionale në pajtim me kërkesat e tregut, rishikimi i programeve që nuk janë konform nevojave të tregut të punës (zvogëlim i programeve ekzistuese 10% duke ridestinuuar resurset në programet adekuate ndërdisiplinare), dhe
- Të zhvillohen rezultate të matshme të programit, që si objektivë strategjike ka kërkimin e zhvillimit të nivelit të programit sipas nevojave të tregut të punës. Ndërsa, aktivitetet e saj janë: implementimi i studimeve të tregut të punës, shfrytëzimi i strategjive të Ministrisë së Punës dhe strategji të tjera qeveritare, shfrytëzimi i parashikimeve të jashtme të tregut të punës (BE, USAID, GIZ) me qëllim të thithjes së fondeve.

⁴¹Strategjia Kombëtare për Zhvillim, ZKM, fq. 14.

⁴²Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017 – 2019, UP, fq. 46 – 48.

Disa nga masat e këtyre aktiviteteve janë: zhvillimi i mekanizmave për implementim të studimit të kërkesave të tregut të punës, shfrytëzimi i studimeve ekzistuese të jashtme të tregut, përgatitja e raporteve për rezultatet e studimeve të tregut, përgatitja e raporteve/dokumenteve që tregojnë orientimet e tregut të punës.

Ndërkaq, në PSUP 2020-2022 në kuadër të fushës strategjike «Nivele/programe të kërkuara nga tregu» parashihen këto iniciativa strategjike:

-
- Arritshmëria e kompetencave konform kërkesave të tregut,
 - Zhvillimi i programeve studimore me zhvillimin e teknologjisë informative,
 - Zhvillimi i programeve studimore konform kërkesave të rajonit dhe më gjerë, dhe
 - Rritja e bashkëpunimit me sektorin e gjerë publik dhe privat.⁴³
-

⁴³ Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2020 – 2022, UP, fq. 53 – 58.

Akreditimi

akreditimi është proces i vlerësimit të programeve studimore që ofrohen nga fakultetet e universiteteve publike dhe jo vetëm për studentët e Republikës së Kosovës. Në Kosovë ekzistojnë dy trupa që merren me procesin e akreditimit: Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë.

Forcimi i funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit në sistemin arsimor është një nga masat e parapara të ndërmerret nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2017-2021. Si aktivitete konkrete të kësaj mase, e që kanë të bëjnë me akreditimin janë llogaritur të jenë:

- Rritja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë për t'i zbatuar Udhëzimet Standarde Evropiane dhe rekomandimet e ENQA/EQAR, si dhe plotësimi i akreditimit me një proces më gjithëpërfshirës të rangimit të programeve sipas Kornizës Multidimensionale Evropiane. dhe
- Përmirësimi i cilësisë së autonomisë dhe llogaridhënies së institucioneve të akredituara përmes zhvillimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të Autoriteteve Akredituese (AAK dhe AKK).⁴⁴

Duhet përmendur një pikë shumë të rëndësishme të PSAK-ut 2017-2021 që lidhet me akreditimin: rishikimi i programeve ekzistuese të studimit. Në kuadër të kësaj pike është paraparë të bëhet rishikimi i programeve ekzistuese të studimit në IAL për të reflektuar kërkesat e tregut të punës. IAL do të themelojnë grupe të specializuara për hulumtimin dhe vlerësimin e kërkesave të tregut të punës sipas fushave përkatëse. Po ashtu, të gjitha programet e reja të studimit do të duhet të dëshmojnë përshtatjen me nevojat e tregut të punës si parakusht ligjor për akreditimin e tyre, përmes studimeve të realizuara sipas standardeve të përcaktuara nga AKA.⁴⁵

⁴⁴Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021, ZKM, fq. 15.

⁴⁵Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 – 2021, MASHT, fq. 99.

Gjithashtu, akreditimi dhe kontrolli i cilësisë është fushë strategjike e PSUP 2017-2019, në kuadër të të cilit janë paraparë të arrihen këto rezultate:

-
- Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies për të arritur rezultate më të mira të mësimin,
 - Rritja e cilësisë së stafit akademik, progresit të studentëve, vlerësimi i lëndës dhe rezultatet e përgjithshme,
 - Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të matjes së rezultateve të studentëve,
 - Krijimi i një fondi të bursave për vizita kërkimore afatshkurta jashtë vendit,
 - Zhvillimi i programeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës në përputhje me Sistemin e Bolonjës,
 - Rritja dhe përmirësimi i rezultateve kërkimore në UP,
 - Përforsimi i marrëdhënieve të universitetit me botën e punës dhe shoqërisë civile, dhe
 - Institucionalizimi i përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë⁴⁶.

Më PSUP 2020-2022, në kuadër të së njëjtës fushë strategjike janë paraparë të arrihen këto rezultate:

-
- Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies për të arritur rezultate më të mira të mësimin dhe rritjes së interesimit për njohuri të ofruara,
 - Rritja e cilësisë së stafit akademik, progresit të studentëve, vlerësimi i lëndës dhe rezultatet e përgjithshme,
 - Krijimi i një fondi të bursave për vizita kërkimore afatshkurta jashtë vendit,
 - Zhvillimi i programeve të doktoratës me synim në gjuhën angleze dhe në përputhje me sistemin e Bolonjës,
 - Rritja dhe përmirësimi i rezultateve shkencore dhe kërkimore në UP,
 - Përforsimi i marrëdhënieve të universitetit me tregun e punës dhe komunitetin,
 - Institucionalizimi i përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë, dhe
 - Dizajnimi dhe implementimi i indikatorëve kyç çelës të performancës akademike (KPI-A)⁴⁷

⁴⁶Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017 – 2019, UP, fq. 16.

⁴⁷Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2020 – 2022, UP, fq. 17.

VLERËSIMI I ZBATIMIT TË INDIKATORËVE PËRMES HULUMTIMIT CILËSOR

Shkallën e zbatimit të indikatorëve të sipërpërmendur mund ta masim vetëm duke e bërë një vlerësim të zbatimit të tyre në praktikë. Të ndikuar nga disa faktorë teknikë, por më së shumti nga pandemia COVID-19, për matjen e zbatimit të objektivave strategjike dhe masave të parapara, kemi marrë si mostra tre fakultete të UP-së: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Filozofisë dhe Fakultetin e Edukimit. Për këtë çështje realizuam intervista me dekanët e këtyre fakulteteve.

Diskutimi ndërinstucional është ndër faktorët kyçë gjatë procesit të hartimit të planeve strategjike. Praktikrat e deritanishme tregojnë që hartimi i këtyre planeve gjithmonë ka shkuar nga lart-poshtë, prandaj shumë prej masave të parapara të ndërmerren kanë dështuar. Është kërkesë imediate dhe më se e nevojshme që planifikimi strategjik të ndodhë nga poshtë-lart, pra të merren rekomandime nga të gjitha njësitë akademike të universiteteve publike se ku duhet vepruar. Për këtë çështje i pyetëm dekanët gjatë intervistave tona dhe që të tre u përgjigjën se komunikimi i drejtpërdrejtë me MASHTI-in ka munguar, kurse UP gjatë hartimit të Planit Strategjik ka marrë disa rekomandime nga ana e tyre. Gjithashtu, i rëndësisë së veçantë është edhe vlerësimi i gjendjes para se të ndodhë hartimi i Planit Strategjik. Kjo vlen sidomos për Planet Strategjike të UP-së. Nga intervistat me dekanët, kemi nxjerrë përfundimin se ka një hendek të madh në mes të planifikimit, monitorimit dhe zbatimit në praktikë të intervenimeve të parapara. Duhet thënë që, për dallim nga PSUP-ja, PSAK-u ka kaluar nëpër procesin e monitorimit. Kështu, duke u nisur nga kjo premisë e ekzistimit të një hendeku në mes të planifikimit dhe zbatimit në praktikë, e pamë të udhës t'i pyesim dekanët se çka do të ndryshonin dhe çka do të përfshiin në planifikimet strategjike për Njësinë e tyre Akademike. Dekani i Fakultetit të Edukimit, z. Blerim Saqipi tha se «ai e ka planin e zhvillimit të fakultetit, sepse kjo kërkohet edhe nga procesi i akreditimit», Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, z. Isak Shabani tha se «na mungon shumë pjesa e PR-it, krijimi i Zyrës së Cilësisë brenda Njësisë Akademike dhe shtimi i stafit të IT-së, duke e krijuar kështu një Zyrë të IT-së. Gjithashtu, edhe riorganizimi i administratës», ndërsa Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Dashmir Bërxulli tha se «gjëja parësore për këtë punë është decentralizimi i kompetencave ekzekutive të njësitë akademike, konkretisht dekanët».

Në kapitujt më lart është përmendur relevanca e transparencës dhe llogaridhënies dhe domosdoshmëria e respektimit të këtyre dy kriterëve në arsimin e lartë.

Universiteti i Prishtinës (UP), sipas hulumtimit të uebfaqes nga ana jonë, por edhe nga informacionet e marra nga ana e dekanëve të intervistuar, ka shënuar një ngritje të konsiderueshme të transparencës. Vendimet, rregulloret, shpalljet, plani strategjik e dokumente të tjerë të UP-së janë të publikuar në uebfaqen e saj. Që ka një ngritje të transparencës pajtohen edhe tre dekanët e intervistuar.

Përveç të sipërpërmendurave, njëra nga pikat e PSAK-ut përfshin edhe përmirësimin e gjendjes infrastrukturore në objektet arsimore. Gjithashtu, shumë e rëndësishme është të dihet edhe a është bërë pajisja me ndonjë laborator shkencor apo bibliotekë. Për këtë çështje Dekani i Fakultetit të Edukimit, z. Blerim Saqipi na tha se «objekti i fakultetit tonë është i ri, tash e 10 vite, kështu që nuk kemi shumë nevoja për investim, më shumë kemi nevojë për mirëmbajtje. Ka pasur disa pajisje shumë të vogla laboratorike në vlera shumë të kufizuara që janë sjellë në vitet e fundit, kurse investimet në teknologji i kemi bërë kryesisht me anë të donacioneve», Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Dashmir Bërxulli tha se «me projektin e Bankës Botërore kemi siguruar fasadën e objektit dhe dritaret e reja, si dhe kemi parashikim të buxhetit për disa renovime të sallave. Sa i përket bibliotekës dhe laboratorit, në katër vitet e fundit nuk ka pasur investime, ndërkaq më herët po. Gjithashtu, kemi plane për të ardhmen», ndërsa dekani i FIEK-ut, z. Isak Shabani tha se «ka pasur investime dhe jemi në proces të investimeve. Gjithashtu, edhe pajisja me laboratorë është bërë dhe për momentin i kemi katër projekte në implementim e sipër».

Indikator shumë i rëndësishëm i arsimit të lartë është edhe puna kërkimore-shkencore. Ndonëse kjo e fundit, sipas PSAK-ut, nuk është e integruar plotësisht në aktivitetet e zakonshme të institucioneve publike arsimore në Kosovë. Shkaku kryesor për një mosintegrim të tillë, sipas dekanit të FIEK-ut, z. Isak Shabani, është mungesa e instituteve dhe puna jo e përbashkët, por individuale shkencore. Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Dashmir Bërxulli shpjegon se «UP është i orientuar më shumë kah pjesa e mësimdhënies, sesa kah shkenca». Ai rekomandon që «doktorantët duhet të jenë pjesë e stafit të universiteteve, për aq kohë sa janë brenda universitetit. Ai që është duke doktoruar duhet të mbajë mësim këtu dhe të bëjë kërkim shkencor bashkë me studentët dhe profesorët». Për dekanin e Fakultetit të Edukimit, z. Blerim Saqipi janë dy shkaqe kryesore: «i pari është mekanizmi inekzistent i financimit të mirëfilltë. Pra, universitetet duhet të financohen me shumën për shkencë, sikur për mësimdhënie. Ndërsa, i dyti është mekanizmi i brendshëm në nivel të UP-së. Pra, në njëfarë mënyre brenda detyrave të punës stafi duhet të ketë obligative një përqindje të angazhimit për të prodhuar shkencë». Sa i përket nivelit të punës kërkimore-shkencore brenda këtyre njësisive akademike, gjendja është duke u përmirësuar.

Në Fakultetin e Edukimit, sipas dekanit Saqipi, janë realizuar rreth 40 punime brenda një viti e gjysmë. Në FIEK, sipas dekanit Shabani, janë duke u implementuar disa projekte, por ka një orientim edhe për hulumtime shkencore. Kurse, në Fakultetin e Filozofisë, sipas dekanit Bërçulli, ka një rritje të botimeve në SCOPUS për kokë profesori. Nga ajo që kemi vërejtur gjatë hulumtimit, një shtysë shumë pozitive në motivimin e stafit akademik për publikime shkencore, ka qenë Rregullorja për Financimin e Botimeve e sjellë nga Universiteti i Prishtinës (UP). Lidhur me kërkimin shkencor, një çështje shumë me rëndësi është edhe bashkëpunimi me diasporën dhe shfrytëzimi i ndihmës që mund të vijë nga diaspora. I po kësaj fryme është Seminari Shkencor i mbajtur me diasporën shqiptare në fushat e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, organizuar nga FIEK-u. Ndërsa, sa i përket mekanizmave për zhvillim profesional të stafit akademik, dekanët përmendën disa trajnime bazike të mësimdhënies, e që natyrisht nuk janë të mjaftueshme. Në këtë pikë duhet të bëhet më shumë. Ndërlidhja e programeve të studimit me tregun e punës është ndër kërkesat më të shpeshta që përmendet nga shumë hisedarë të arsimit të lartë. Kjo çështje ishte ndër preokupimet tona kryesore që e diskutuam me dekanët dhe kërkuam të dimë më shumë. Dekani i Fakultetit të Edukimit, z. Saqipi, na tha se «te ne kjo është mjaft e thjeshtë, sepse ne udhëhiqemi prej Rregullativës ligjore që e miraton MASHTI dhe ne i qëndrojmë besnik kësaj». Dekani i FIEK, z. Shabani, tha se «programet e studimit që ofron fakulteti janë shumë në përputhje me kërkesat e tregut të punës», ndërsa Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Bërçulli na tha se «ne përpiqemi t'i lidhim programet e studimit me tregun e punës, duke e pasur parasysh se ku mund të punësohen. Në disa departamente kemi 83% të punësuar në profesion, p.sh. në psikologji, ndërsa në disa departamente tjera është vështirë të ndryshohet planprogrami në çdo moment». Përveç ndërlidhjes me tregun e punës e rëndësishme është të dihet edhe mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik. Në FIEK, sipas dekanit Shabani, kryhet mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik. Fakulteti i Edukimit, sipas dekanit Saqipi, ka pasur tri marrëveshje të negociuara me fakultete të Edukimit në Evropë, marrëveshje të cilat i përfshijnë 30 studentë dhe 10 deri në 15 profesorë. Ndërsa, Fakulteti i Filozofisë, sipas Dekanit Bërçulli, ka disa marrëveshje të ERASMUS-it të cilat i kanë shfrytëzuar studentët e këtij fakulteti. Duhet thënë që marrëveshjet e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve janë të menaxhuara në nivel të Rektoratit dhe në to kanë qasje të gjithë studentët për të aplikuar dhe për t'i ndjekur pastaj procedurat vijuese të rekrutimit. Po aq i rëndësishëm sa mobiliteti i studentëve është edhe praktika profesionale që kryhet gjatë studimeve. Prandaj, morëm informacione nga dekanët se a kryejnë praktikë profesionale studentët e këtyre fakulteteve gjatë studimeve dhe kështu

informuam se studentët e Fakultetit të Edukimit, praktikën profesionale e kanë obligative brenda planprogrameve dhe të gjithë e kryejnë, studentët e Fakultetit të Filozofisë bëjnë praktikë në institucione që ndërlidhen me programet e studimit që i ofron ky fakultet, siç janë: Qendra për Punë Sociale, ministri të ndryshme, klinika, etj., ndërsa studentët e FIEK-ut praktikën profesionale e kanë lëndë të veçantë gjatë studimeve, gjithashtu edhe një internship.

Një parim shumë i rëndësishëm për t'u respektuar nga ana e njësive akademike është parimi i gjithëpërfshirjes. Prandaj, u interesuam për të kuptuar se a kanë njësitë akademike studentë me nevoja të veçanta dhe të komuniteteve joshumicë, si dhe sa i plotësojnë kushtet objektet për studentët me nevoja të veçanta. Dekani i Fakultetit të Edukimit, z. Blerim Saqipi, tha «kemi studentë nga komunitetet joshumicë, por jo shumë. Edhe vitin e kaluar nuk janë plotësuar të gjitha kuotat e parapara për studentë të komuniteteve joshumicë». Ndërsa, për studentë me nevoja të veçanta, dekani tha se «objekti i plotëson kushtet, kemi qasje për karroca dhe kemi ashensorin». Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Dashamir Bërxulli, tha se «Kemi studentë të komuniteteve joshumicë». Ndërsa, për studentët me nevoja të veçanta, ai shtoi: «kemi studentë me nevoja të veçanta, ndërsa kushtet për këta studentë nuk mund t'i plotësojmë shumë, ata vijnë me dikë në fakultet. Nuk jemi të kënaqur sepse nuk kemi menduar në këtë drejtim dhe nuk kemi fonde. Fakulteti i Filozofisë nuk ka evidencë të këtyre studentëve». Kurse dekani i FIEK, z. Isak Shabani tha se «kemi studentë nga komunitetet joshumicë», ndërsa për studentët me nevoja të veçanta ai tha se «objekti i plotëson kushtet: hyrja punon, gjithashtu edhe ashensori, por nuk ka studentë të deklaruar si të tillë».

Indikatori i fundit të cilin e kemi shqyrtuar ka qenë akreditimi. Nga njësitë akademike morëm informacione për procesin e fundit të akreditimit dhe në parim përshtypjet ishin pozitive. Dekani i Fakultetit të Filozofisë, z. Dashamir Bërxulli na tha se «këtë vit janë akredituar 9 programe: 3 në Bachelor, 6 në Master. 2 programe janë akredituar për 5 vite, kurse të tjerat për 3 vite. Në programet e riakredituara kanë ndryshuar lëndët, metodat e vlerësimit, syllabuset, etj.». Dekani i Fakultetit të Edukimit, z. Blerim Saqipi, sqaroi se «i kemi pasur 15 programe, nga to 1 program nuk është akredituar, e për të cilin jemi pajtuar me disa vërejtje, por mendojmë që ekspertët nuk e kanë kuptuar mirë relevancën e këtij programi: pedagogji për shkolla profesionale. Ky program i masterit ka qenë i kërkuar nga MASHTI, por eksperti ka thënë që program të tillë nuk ka askund në botë». Ndërsa, dekani i FIEK, z. Isak Shabani tha se «kemi aplikuar me 8 programe, nga to 6 janë aprovuar, 1 nuk është aprovuar dhe 1 është në proces të akreditimit. Programi Elektroenergjetikë nuk është akredituar dhe raporti i ekspertit është publik. Të gjitha programet kanë ndryshuar në emër dhe në përmbajtje, në harmoni me programet moderne dhe bashkëkohore».

REKOMANDIMET

Pasi kemi analizuar të gjitha dokumentet, kemi zhvilluar intervistat dhe takimet në terren, gjatë konsultave e diskutimeve të vazhdueshme me recensentin dhe konsulentin e këtij raporti, prof. Xhavit Rexhaj. kemi arritur në përfundim se rekomandimet duhet të jenë si vijon:

Në rrafsh vendor:

Kërkohet sigurimi i koherencës dhe i standardizimit të qasjes në planifikim strategjik. Përgjegjëse për koordinimin e këtyre përpjekjeve mund të jetë Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit. Ky standardizim mund të bëjë standardizimin në përputhje me udhëzimet për planifikim të përfshira në doracakun e kësaj zyre në uebfaqen e qeverisë. Standardizimi do të nënkuptonte:

- metodologjinë dhe qasjen e planifikimit,
- sigurimin e informatave,
- koherencën në mes të qëllimeve dhe objektivave strategjike në nivele të ndryshme, dhe
- terminologjinë dhe konceptet kryesore të planifikimit e të tjera.

Duhet siguruar bashkëpunimi ndërinstitucional (vertikal dhe horizontal) për të mundësuar koherencë të qëllimeve dhe qasjeve në planifikim. Kjo do të siguronte sinergji të përpjekjeve në vend të dyfishimit dhe kolizionit në mes tyre.

Në rrafsh sektorial: MASHTI

Në nivel të MASHTI-t duhet siguruar ndërlidhja dhe koordinimi më i mirë me institucionet vartëse në sektorin e arsimit. Kjo mund të arrihet me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e planifikimit, me hartimin e metodologjive dhe mekanizmave të përbashkëta të monitorimit (sidomos për zbatimin e segmentit të financimit) dhe me zhvillimin e bazës së integruar ose komplementare të të dhënave në sektorin e arsimit.

Në rrafsh institucional: Universiteti i Prishtinës

- Sugjerohet rishikimi i mirëfilltë i strategjisë 2020-2022 (për t'u koordinuar më mirë me planet përkatëse të qeverisë e të ministrisë),
 - Rekomandohet hartimi i një Plani unik në nivel të UP dhe pjesëmarrje të gjerë në procesin e planifikimit. Nga njësitë akademike do të kërkohej hartimi i planeve vjetore të veprimit,
 - Të standardizohet Korniza, mekanizmi dhe të ndërtohen kapacitetet për monitorimin e zbatimit të Planit,
 - Të sigurohet transparenca e shtuar për zbatimin e planit si brenda ashtu edhe jashtë institucionit të AL,
 - Të realizohet ndërlidhja organike e masave të Planit me buxhetin dhe akreditimin, ashtu siç kërkohet në dispozita përkatëse ligjore dhe nënligjore, dhe
 - PSAK-u mund të shërbente si model për hartimin e Planit strategjik të institucioneve të arsimit të lartë.
-

Gjithashtu, një numër i rekomandimeve shumë të dobishme kanë dalë edhe nga tryeza e diskutimit e mbajtur më 21 shtator 2021. Disa prej tyre janë shënuar më poshtë:

- IAL dhe autoritetet duhet të angazhohen në procese të mirëfillta të planifikimit e jo në planifikim formal,
 - Duhet të bëhet planifikimi i bazuar në vlerësim real të gjendjes. Vlerësimi real i gjendjes duhet të ketë pjesëmarrje të shtuar në të gjitha trupat e planifikimit,
 - Të ketë koherencë dhe konvergjencë në mes të planifikimeve të niveleve të ndryshme si dhe një plan unik strategjik në nivel të IAL dhe pastaj operacionalizim të të njëjtit në plane operationale. Të sqarohet niveli dhe forma e planifikimit. Duhet të sigurohen mekanizma të veçantë të monitorimit dhe të zbatimit të planeve strategjike në nivelet përkatëse,
 - Duhet të bëhet planifikimi strategjik i bazuar në të dhëna, sepse nuk mund të ketë planifikim të mirëfilltë pa të dhëna relevante, të sakta dhe të besueshme, dhe
 - Duhet të fokusohemi më shumë te puna shkencore e bazuar në projekte autentike shkencore dhe te zhvillimi i kapaciteteve institucionale-instituteve shkencore në njësitë akademike.
-

REFERENCAT

- [1]** Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës, Organizata për Rritjen e Cilësë në Arsim (ORCA), Prishtinë, prill 2021;
- [2]** Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, MASHTI;
- [3]** Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2017-2019, UP;
- [4]** Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2020-2022, UP;
- [5]** Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, ZKM;

STRATEGJITË NË
FUSHËN E ARSIMIT
TË LARTË NË KOSOVË

